PEJË

Vritet një grua, arrestohet bashkëshorti



Policia ka njoftuar se rasti ka ndodhur në rrugën "Bill Clinton" në Pejë

Një grua është vrarë të martën në Pejë, e vrasja dyshohet se është kryer nga bashkëshorti i saj.

Zëdhënësi i Prokurorisë Themelore në Pejë, Shkodran Nikçi, e ka konfirmuar rastin për KOHËN, duke njoftuar se vrasja ka ndodhur me armë zjarri.

I dyshuari është arrestuar e në vendin e ngjarjes kanë dalë ekipet relevante.

"Në Pejë ka ndodhur një rast i vrasjes, ku dyshohet se në një banesë në qendër të Pejës bashkëshorti ka privuar nga jeta gruan e tij. Aktualisht në vendin e ngjarjes është kryeprokurori, prokurori, krimet e rënda dhe të gjitha ekipet relevante. Po e presim Mjekësinë Ligjore për të marrë trupin e pajetë. Është arrestuar i dyshuari", ka thënë Nikçi.

Policia ka njoftuar se vrasja e 43-vjeçares ka ndodhur në rrugën "Bill Clinton".

"Sot rreth orës 08:15, Policia është informuar se në rrugën 'Bill Clinton' në Pejë, ka ndodhur një rast, Policia menjëherë kanë dal në vendin e ngjarjes gjithashtu edhe ekipi mjekësor të cilët kanë konstatuar vdekjen e viktimës (femër), i dyshuari këtij rasti është arrestuar dhe ndodhet ne objektet e Stacionit Policor në Pejë", thuhet në njoftimin e zëdhënësit të Policisë për rajonin e Pejës, Driton Rugova.

Kjo është vrasja e dytë brenda pak ditëve në Kosovë.

Të premten (12 prill) është vrarë me armë zjarri një 21-vjeçare në Ferizaj në Qendrën për Punë Sociale.

Vrasja dyshohet se është kryer nga bashkëshorti i saj.

LEXO EDHE:

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë vendim që të mërkurën (17 prill) ta shpallë ditë zie, duke shtuar se "shoqëria do të jetë ditë zie çdo ditë përderisa të ketë vrasje të grave dhe vajzave".

"Fatkeqësisht sot të gjithë jemi zgjuar sot në mëngjes me lajmin e tmerrshëm për vrasjen edhe të një gruaje nga bashkëshorti i saj. Ky fenomen i tmerrshëm që po plagos shoqërinë dhe shtetin tonë, ky femicid me përmasa të jashtëzakonshme duhet të ndalet me çdo kusht. Mënyra e vetme për të ndalë atë është nëse rizgjohemi të gjithë si shoqëri, si shtet dhe si komb", ka thënë Osmani.

Për këtë ndodhi, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, njëherit Koordinatore Kombëtare për Mbrojtjes nga Dhuna, ka mbajtur takim me përfaqësues të institucioneve së drejtësisë.

E, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka kërkuar konsolidim të gjyqësisë dhe të sigurisë për parandalimin e vrasjeve të grave.

Ai ka shtuar se lajmi i vrasjes së gruas në Pejë ishte i trishtueshëm.

Reagime për këtë rast ka pasur edhe nga opozita.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, i ka ftuar organet e sigurisë të veprojnë me përgjegjësi ndaj rasteve të tilla, duke thënë se shteti "duhet të jetë mburojë për gratë".

"Jeta e tyre nuk guxon të mbetet jetë për mbijetesë. Nga lehtësia e posedimit të armës së zjarrit, te gjendja reaktive e institucioneve tona, kushtet strehuese të grave që kërkojnë mbrojtje, e gjuha denigruese ndaj grave; problemet i kemi të shumta e veprimet plotësisht të pamjaftueshme. LDK do ta shqyrtojë çdo mundësi institucionale që të ngritë diskutimin rreth vendimmarrjes institucionale për parandalimin e rasteve të tilla", ka shkruar LDK-ja në Facebook.

Memli Krasniqi, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka thënë se ky rast është alarmi që duhet të zgjojë secilin person që ka përgjegjësi për garantim të sigurisë së qytetarëve.

"Dy gra të vrara në tri ditë nga partnerët e tyre – të cilët kanë qenë edhe më parë të denoncuar në polici për çështje të dhunës në familje. Ky është alarmi që duhet të zgjojë secilin person që ka sado pak përgjegjësi për të garantuar sigurinë e qytetarëve – e institucionet shtetërore kanë më së shumti", ka shkruar Krasniqi në Facebook.

#VRASJE #GRATE #PEJA

Taboola Feed

Kërcënohet ambasadori Hill
Kohanet

Vuçiq: Ndërkombëtarët po e konsiderojnë proces normal anëtarësimin e Kosovës në…
Kohanet

Nga: Ermir Bujupaj
16 prill 2024 09:00
Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Showbiz. Meghan Markle me produktin e parë nga brendi i ri që ka krijuar

Botë. Danimarka zotohet të rindërtojë ndërtesën historike që u përfshi nga zjarri

Botë. Presidenti i Iranit paralajmëron përgjigjje "masive" ndaj Izraelit

Botë. Anulimi i fluturimeve mes tensioneve Iran-Izrael

Arbëri. Von Cramon: Serbia t'i lirojë kosovarët, mos ta turpërojë veten

Arbëri. Zulfaj për bllokimin e kosovarëve në Serbi: Putini i vogël s'mund ta përballojë suksesin e Kosovës

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing
Politika e privatësisë
Kushtet e përdorimit

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

EN DE FR ES GR SR TR MK

+383 (0) 38 249 105 / info@koha.net

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorsh Bush p.n., 10000 Prishtinë